

**EDUARD SHEHI**

Instituti i Arkeologjisë / Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë  
eduardshehi@hotmail.com

**DETAJE MBI SULMIN DHE PLAÇKITJEN E DURRËSIT NË  
VITIN 1606 SIPAS BURIMEVE SPANJOLLE****Abstrakt:**

*Artikulli trajton sulmin spanjoll të Durrësit më 5 gusht 1606, mbështetur në dokumentet spanjolle. Në artikull janë dhënë mendime mbi vendqëndrimin e anijeve spanjolle, vendzbarkimin, rrugëtimin deri pranë kalasë dhe organizimin ushtarak të ekspeditës. Bazuar mbi detajet e përcjella nga dokumentet është bërë një analizë mbi aspektet ushtarake të sulmit, mbi madhësinë e garnizonit mbrojtës dhe arsyet e mungesës së një mbrojtjeje efikase. Janë trajtuar çështje të lidhura me numrin e popullsisë, me bazën ekonomike dhe nivelin e zhvillimit të Durrësit deri në vitin 1606.*

*Vrasjet dhe plaçkitjet kanë ndërprerë ritmin e zhvillimit, duke e kthyer Durrësin 100 vite pas, si në pragun e pushtimit osman. Shqiptarët kanë menduar dhe shpresuar se ky sulm ishte prelude i një aksioni më të madh antiosman, duke qenë të gatshëm për t'u ngritur në luftë. Por një gjë e tillë nuk ka ndodhur, duke humbur mundësinë e fundit për të çliruar territoret e Ballkanit Perëndimor nga sundimi osman.*

**Fjalë kyçe:**

Durrësi osman, pushtimi spanjoll 1606, topografi, urbanistikë, ekonomi.

Në vitin 1501, pak kohë para pushtimit osman, Durrësi përshkruhet si një qytet i rrënuar dhe i braktisur. Brenda tij numëroheshin vetëm 200 burra të aftë për luftë, që duhej të mbronin një perimetër fortifikimesh prej 5 miljesh.<sup>1</sup> Ky numër përkon pak a shumë me një popullsi prej 320-400 vetash.<sup>2</sup> Menjëherë pas pushtimit osmanët filluan të kryejnë punime ndërtimore me qëllim rifortifikimin e zvogëlimin e perimetrit të kalasë.<sup>3</sup> Nuk ka mjaftueshëm të dhëna të qarta për të kuptuar me detaje zhvillimin e Durrësit përgjatë shekullit të parë nën administrimin osman. Njohim më së shumti lëvizje të garnizonit ushtarak për arsye ndërtimore ose përballjet me flotat perëndimore. Në tetor të vitit 1501 ishin dërguar në Durrës 100 kalorës dhe 600 ushtarë në kuadrin e punimeve fortifikuese.<sup>4</sup> Në vitin 1504 përmenden 800 ushtarë në kala, në pritje të një sulmi.<sup>5</sup> Në vitin 1530 kalaja ruhej nga 255 trupa.<sup>6</sup> Në vitin 1570 numri i garnizonit jepet në 200 jeniçerë, 200 azapë dhe 300 forca të parregullta.<sup>7</sup> Kemi kështu një total prej 700 vetash, por autori i relacionit shton se pritej një sulm. Këto të dhëna bëjnë fjalë gjithmonë për ushtarakë, pa ditur nëse kishte edhe banorë civilë, pjesë ose jo e familjarëve të ushtarakëve.

Në aspektin ekonomik ka pasur një nivel të kufizuar tregtie, e cila sillte përfitime edhe në formën e taksave. Pas pushtimit të vitit 1501 përmendja e parë që hasim për ndërtimin e një skele i takon vitit 1532, ku raportohet se punohej në mënyrë që flota të arrinte bregun pa vështirësi.<sup>8</sup>

<sup>1</sup> Marino Sanuto, *I diarii di Marino Sanuto IV* (Venezia: Visentini, 1880), kol. 15-16; Marino Sanuto, *I diarii di Marino Sanuto III* (Venezia: Visentini, 1880), kol. 943-944.

<sup>2</sup> Eduard Shehi, *Topografia e Durrësit mesjetar*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Arkeologjisë (Tiranë: 2022), 426.

<sup>3</sup> M. Sanuto, *I diarii ... IV*, kol. 368; shih: Selami Pulaha (bot.), *Lufta shqiptaro-turke në shekullin XV. Burime osmane* (Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës, 1968), 182, 273.

<sup>4</sup> M. Sanuto, *I diarii ... IV*, kol. 368.

<sup>5</sup> Marino Sanuto, *I diarii di Marino Sanuto V* (Venezia: Visentini, 1881), kol. 1002.

<sup>6</sup> Eduart Caka, “Tipologji të një qyteti kufitar: Durrësi gjatë dy shekujve të parë të sundimit osman (shek. XVI-XVII)”, *Studime historike* 1-2 (2020), 74.

<sup>7</sup> Sime Ljubic (bot.), *Starine na sviet izdaje*, Jugoslavenska Akademija Znanosti i Umjetnosti, Knjiga XII (Zagreb: Knjižari Lavoslava Hartmana na Prodaju, 1880), 194-195, “Relazione dell’ Albania e sue citta, fiumi, monti, laghi, piani, confini etc. fatta l’anno 1570”.

<sup>8</sup> Marino Sanuto, *I diarii di Marino Sanuto LVI* (Venezia: Visentini, 1901), kol. 412.

Tregtarët dhe skela e Durrësit përmenden edhe në vitet 1560, 1566, 1567, 1568.<sup>9</sup>

### **Paqartësi mbi ngjarjen e vitit 1606**

Periudha e administrimit osman të Durrësit konsiderohet përgjithësisht një fazë monotone e historisë së qytetit, me pak elemente interesante për t'u analizuar. Studimet e viteve të fundit kanë treguar se përtej kësaj perdeje monotone fshihet një histori aktive, me shumë elemente interesante, të cilat janë të nevojshme të njihen dhe të studiohen.<sup>10</sup> Një nga momentet më të rëndësishme, dhe të dhimbshme për jetën e Durrësit nën administrimin osman, lidhet me pushtimin, plaçkitjen dhe djegien nga flota spanjolle e Mbretërisë së Napolit më 4-5 gusht 1606.<sup>11</sup>

Kjo ngjarje ka hedhur një vello mjegulle në raportet diplomatike të fuqive rajonale të kohës. Mes diplomatëve kishte mungesë njohurish se kush e kishte realizuar këtë sulm. Të dhënat që u dërgoheshin qeverive përkatëse reflektojnë pikërisht këtë kaos informativ. Futja e flotës spanjolle në Adriatik dhe pushtimi i portit të Durrësit sollti përplasje interesash mes fuqive europiane, përfshirë edhe anglezët. Në burimet arkivore, të cilat na përcjellin komunikimet e ambasadorit të mbretit të Anglisë në Venedik, vërehet një fakt i tillë.<sup>12</sup>

Më 13 shtator 1606, ambasadori francez pranë Portës së Lartë bën me dije se kanë qenë 12 galera të krishtera që kanë plaçkitur Durrësin, duke marrë shumë municione dhe 200 copë artileri. Para se të largoheshin kanë rrëzuar kështjellën, ku thuajse nuk kishte fare roje. Sipas tij, osmanët kanë akuzuar venedikasit dhe është thirrur një përfaqësues i Sinjorisë pranë Portës së Lartë, i cili ka akuzuar galerat

<sup>9</sup> E. Caka, "Tipologji të një qyteti kufitar...", 77, 81.

<sup>10</sup> Eduard Shehi, Rudenc Ruka & Eduart Caka, "Shënime mbi fortifikimet e Durrësit në periudhën osmane", *Studime historike* 3-4 (2020), 61-116; E. Caka, "Tipologji të një qyteti kufitar...", 63-86.

<sup>11</sup> Pëllumb Xhufi, *Árbërit e Jonit. Vlora, Delvina e Janina në shekujt XV-XVII*, QSA, Instituti i Historisë (Tiranë: Onufri, 2016), 1214 dhe dokumentet e cituara prej tij; Ardian Muhaj, *Nga Ballkani në Mesdhe. Shqiptarët prej Mesjetës në agimin e kohës së re*, Akademia e Studimeve Albanologjike, (Tiranë: 2019), 103.

<sup>12</sup> Horatio F. Brown (ed.), *Calendar of State Papers Relating to English Affairs, Existing in the Archives of Venice and in Northern Italy*, Vol. X, 1603-1607 (London: 1900), dok. nr. 577 (1605-1606), shtator 1606.

spanjolle të nisura nga Mesina. Por informatori thotë se ende nuk e di edhe ai vetë se kush e ka bërë sulmin.<sup>13</sup> Një informacion i tillë duket se më shumë bazohet në fjalë të dëgjuara kalimthi, sesa në dëshmi të provuara.

Me kalimin e ditëve ka filluar të qartësohet situata dhe të shpërndahen informacionet e vërteta. Fra Paolo Sarpi shkruante se kishte qenë markezi Santa Kruz, i cili me bekimin e Papës, me 26 galera kishte lundruar me fshehtësi për t'iu ruajtur flotës venedikase. Sipas tij sulmi ka ndodhur më 10 gusht 1606, dhe me pak mundim u plaçkit dhe u dogj Durrësi. Spanjollët morën 155 skllëvër si dhe nga 30 copë artileri që kishte qyteti ngarkuan në anijet e tyre ato që mund të transportoheshin, të tjerat i gozhduan.<sup>14</sup> Në një informacion, dhënë më 27 gusht 1606, shkruhej se markezi Santa Kruz, me një flotilje prej 14 galerash dhe 8 kompani këmbësorësh ka pushtuar dhe plaçkitur Durrësin më 7 gusht.<sup>15</sup> Më 9 shtator ambasadori anglez në Venedik në bisedë me doxhën pyet mbi arsyet e sulmit të Santa Kruzit, nëse kishte qenë një aksion personal i tij, i shtyrë nga mbreti spanjoll apo nga Papati.<sup>16</sup> Më 29 shtator në një tjetër dokument shkruhet se më së fundi u qartësua se plaçkitja e Durrësit është bërë nga galerat e Napolit, dhe se Kapiteni i Detit venedikas ka informuar Portën e Lartë edhe për rrugëtimin e mëtejshëm të flotës spanjolle.<sup>17</sup>

<sup>13</sup> J. de Gontaut Biron, *Ambassade en Turquie de Jean de Gontaut-Biron, Baron de Salignac: 1605 à 1610. Correspondance diplomatique et documents inédits*, publiés et annotés par le Comte Théodore de Gontaut Biron (Paris: 1889), 87; Injac Zamputi (përg.), *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë, vëllimi III (1603-1621)* (Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, 1989), dok. nr. 21 (67).

<sup>14</sup> M. D. Busnelli dhe Giovanni Gambarin (bot.), *Fra Paolo Sarpi, Istoria dell'Interdetto e altri scritti editi e inediti*, vol. 1. Scrittori d'Italia, dok. nr. 179 (Bari: Gius. Laterza & Figli, 1940), 99-100; I. Zamputi, *Dokumente të shekujve XVI-XVII ...*, dok. nr. 19 (63-64).

<sup>15</sup> J. de Gontaut Biron, *Ambassade en Turquie de Jean de Gontaut-Biron ...*, 76, cit. 3; I. Zamputi, *Dokumente të shekujve XVI-XVII ...*, dok. nr. 18 (63).

<sup>16</sup> H. F. Brown (ed.) *Calendar of State Papers ...*, dok. nr. 577 (1605-1606), shtator 1606.

<sup>17</sup> J. de Gontaut Biron, *Ambassade en Turquie de Jean de Gontaut-Biron ...*, 93. I. Zamputi, *Dokumente të shekujve XVI-XVII ...*, dok. nr. 23 (70-71).

## Rrjedha e ngjarjeve sipas ushtarakëve spanjollë

Falë dy dokumenteve të shkruara nga dy dëshmitarë të sulmit mund të paraqesim një përshkrim të detajuar të të gjithë situatës. Bëhet fjalë për ushtarin spanjoll Miguel de Castro<sup>18</sup> dhe markezin Santa Kruz (Santa Croce D. Álvaro de Bazán).<sup>19</sup> Dokumenti i dytë është një raport që i drejtohet zëvendësbretit spanjoll në Napoli. Ne i kemi ndërthurur të dhënat e të dyja burimeve, por duke i besuar më shumë raportit të markezit për disa detaje.

Në burimet arkivore arsyet për të cilat u ndërmor ky sulm hasen në dy raste. Vetë markezi shkruante se synohej të eliminohej një bazë e anijeve pirate. Në një dokument të vitit 1692 Durrësi konsiderohej gjithashtu si fole piratësh, prej ku kishin nisjen sulmet ndaj Puljes. Për këtë arsye ishte marrë vendimi që për të çliruar territoret e Mbretërisë së Napolit nga një problem i tillë duhej zhdukur Durrësi.<sup>20</sup>

Markezi është nisur nga Napoli me disa anije dhe ka ardhur në brigjet e Otrantos në Pulja. Përpjekja e parë për të lundruar në drejtim të Durrësit ka ndodhur më 27 korrik. Flota spanjolle i është afruar bregdetit shqiptar, deri në 30 milje. Si pasojë e erës së papërshtatshme, nuk është vlerësuar se mund të ndërmerrej ndonjë aksion, e për rrjedhojë është vendosur që të ktheheshin. Por, së pari janë zbritur në tokë dy ushtarë, për t'u fshehur në bregdet e për të hetuar nëse anijet ishin parë nga toka, duke alarmuar kështu ushtrinë osmane.

Më pas, flota është kthyer për në Brindisi në mesditën e 28 korrikut. Pas disa ditësh pushim skuadrilja ka ridalë në det, me drejtim Durrësin ku kanë arritur më 4 gusht, në të njëjtin vend si edhe më parë. Dy ushtarët e lënë në bregdet janë kthyer në anije, duke njoftuar se nuk ka pasur asnjë lëvizje në tokë.

Pas mesnatës, ushtarët kanë zbritur nëpër varka dhe kanë vozitur drejt tokës. Rreth orës 03:00 të datës 5 gusht kanë zbarkuar në bregdet. Me një mesatare lundrimi të pranuar gjerësisht prej 5.5-7.5 km në orë me

<sup>18</sup> A. Paz y Mélia, *Vida del soldado español Miguel de Castro (1593-1611)*, escrita por el mismo (Barcelona - Madrid: L'Avenç-Libreria de M. Murillo, 1900), 30-34.

<sup>19</sup> *Arkivi Simancas*, Estado Leg. 1103, nr. 150. Relacion i markezit Santa Cruz për Filipin III, Otranto, 7.VIII.1606.

<sup>20</sup> Domenico Antonio Parrino, *Teatro eroico, e politico de' governi de' Vicere del Regno di Napoli*, tomo secondo (Napoli: 1692), 41.

varka me rrema, spanjollët duhet të kenë përshkruar nga 16.5 deri në 22.5 km. Duke pasur parasysh se gjatësia e Gjirit të Durrësit nga pika më veriore në atë më jugore është vetëm 18 km, largësia e përshkruar me varka ka qenë e konsiderueshme. Ky lundrim nënkupton synimin për t'i afruar ushtarët sa më pranë kalasë, duke shkurtuar rrugën që do të përshkruhej më këmbë. Afër kalasë së Durrësit është arritur pothuajse gjysmë ore para se të lindte dielli. Duke qenë se aktualisht më 5 gusht dielli lind në Durrës rreth orës 05:41, ushtarët spanjollë kanë marshuar për afro 2 orë, duke përshkruar afërsisht 8-10 km.<sup>21</sup>

Pozicioni i saktë i ancorimit të flotës spanjolle nuk njihet, as largësia nga bregu, por ndoshta ka qenë në jug të Kepit të Lagjit, në mënyrë që të mos shihej nga Durrësi. Ne kemi bërë një propozim orientues duke marrë parasysh përlllogaritjen e kohëzgjatjes së lundrimit me varka dhe marshimin përgjatë bregdetit (fig. 1). Mendojmë se vendzëbarkimi i varkave në bregdet duhet të ketë qenë pranë Shkëmbit të Kavajës, si e vetmja pikë orientimi pamore në Gjirin e Durrësit. Nga këtu deri në hyrje të kalasë së Durrësit është afërsisht 8.5 km distancë në këmbë (duke marrë parasysh terrenin kënetor të shek. XVII dhe jo bregdetin e sotëm).

Armata spanjolle, e përbërë prej 3 500 vetash, ishte e ndarë në disa njësi, mes marinarëve dhe trupave tokësore. Në tokë kanë zbritur vetëm ushtarët dhe kalorësit e marinës, të organizuar në kompani me detyra të veçanta. Grupi i xhenierëve kishte për detyrë të shpërthente portat e kalasë me eksploziv. Përbëhej prej 20 vetash, nën komandën e kapitenit Antonio de Mendoza. Kompania e parë, nën drejtimin e Cristobal Alvarez, duhej të pushtonte sheshin e qytetit dhe do të hynte e para brenda kalasë. Një synim i tillë nënkupton vazhdimin pothuaj në vijë të drejtë nga Porta e Detit drejt qendrës së kalasë (fig. 2-3). Kompania e dytë, nën drejtimin e Antonio de la Haya-s, pas hyrjes nëpërmjet Portës së Detit, duhej të ndiqte rrugicën që gjendej në të djathtë të portës (fig. 2). Kompania e tretë, nën drejtimin e Sancho del Barrio-s, kishte si urdhër që të ndiqte rrugicën që gjendej në të majtë të portës (fig. 2). Kompania e katërt, nën drejtimin e Juan Morales, duhej të merrte nën kontroll portën e vogël të kështjellës (quajtur portë e rreme nga ushtari Miguel de Castro). Ajo gjendej në faqen perëndimore të kështjellës, që nënkupton

<sup>21</sup> Shpejtësia e ecjes për një mashkull të rritur përlllogaritët në 4 km për një orë. Shih: <https://www.ramblers.org.uk/advice/navigation/calculating-walking-pace.aspx#:~:text=Average%20speeds,walk%20further%20in%20an%20hour.>

një ngjitje në shpatin e kodrës, pa hyrë në qytet (fig. 2). Kompania e pestë, nën drejtimin don Melchor de Moxica, duhej të merrte nën kontroll Portën e Madhe, për të mos lejuar daljen e banorëve, apo ardhjen e ndihmave nga jashtë. Mbetet e paqartë nëse kjo kompani ka hyrë brenda qytetit apo jo. Synimi mund të realizohej në të dyja versionet (fig. 2). Pasi të gjitha kompanitë të kishin arritur në vendet e synuara do të afrohej vetë markezi Santa Kruz me flotën dhe pjesën tjetër të ushtrisë.

E gjithë trupa ushtarake ka udhëtuar në dy grupe. Grupi i parë përbëhej nga kompania e xhenierëve dhe nga tri kompanitë e para. Grupi i dytë përbëhej nga kompanitë 4 dhe 5 dhe kanë ndjekur një rrugë më të gjatë. Me sa duket xhenierët kanë kaluar nëpër kanalin e lagunës, sot e njohur me toponimin Ura e Dajlanit, përmendur nga ushtari Miguel si cekëtinë, 12 stade e gjerë, 0.5 stade e thellë. Grupi i dytë duket se ka kaluar nëpër një zonë që emërtohet si përrua, ku uji ishte i lartë deri në bel, i mbushur me baltë dhe degë pemësh. Përrenj në zonë mund të jenë vetëm ata që zbrisnin nga kodrat, por këta ishin dimërorë. Mendojmë se spanjollët kanë kaluar në pjesën veriore të kanalit që lidhte kënetën me detin, pranë zonës së kriporeve.

Kolona e parë duke ndjekur brezin e rërës së bregdetit është afruar te Porta e Detit (fig. 2-3), ku kanë parë dy anije të ankoruara. Ushtari Miguel identifikon vetëm njërën si venedikase, ndërsa markezi i cilëson të dyja si të tilla.

Kompania e xhenierëve ka arritur e para te Porta e Detit. Të gjithë brezin fortifikues në këtë pjesë të bregdetit markezi e cilëson se ishte shumë e fuqishme. Xhenierët kanë vendosur eksploziv te dera, duke e shkallmuar atë, por spanjollët nuk ishin të informuar mbi praninë e një porte të dytë, më thellë, në muret e kurtinës, me kangjella metalike. Fuqia e shpërthimit këtu ka arritur të shkallmojë portën dhe një pjesë të murit. Më pas, kanë hyrë brenda tri kompanitë e para. Sipas Miguel de Castro-s, vetëm katër ushtarë osmanë me shpata në duar kanë dalë te Porta e Detit. Përgjatë përbaljes së shkurtër që ka pasuar vetëm një ushtar spanjoll është plagosur rëndë.

Ushtari Miguel rrëfen më pas rrugëtimin për pushtimin e kështjellës. Rruga për të shkuar atje cilësohet e vogël dhe e ngushtë. Nëpërmjet saj ushtarët janë afruar te porta e kështjellës, pikërisht në momentin kur një ushtar osman po përpiquej që ta mbyllte atë. Ndërsa raporti i markezit Santa Kruz tregon se ushtarët osmanë janë tërhequr në kështjellë, prandaj ka pasur një bombardim të shkurtër nga ana e spanjollëve, pasuar nga

pushtimi. Mbetet e paqartë arsyeja e këtyre dallimeve në rrëfimet mes dy burimeve. Në këtë rast nuk mund të shprehemi me siguri se cili version është më afër së vërtetës, pasi Miguel de Castro rrëfen se ka qenë pjesë e grupit të ushtarëve që hynë të parët në kështjellë, pa përmendur ndonjë bombardim apo qëndresë të osmanëve. Ndoshta markezi ka dashur ta zbukurojë e dramatizojë çështjen në raportin zyrtar.

Kompania e katërt kishte shtënë nën kontroll Portën e Madhe, duke thyer urën e drunjtë mbi hendek dhe godisnin banorët e prapatokës që përpiqeshin të afroreshin për ndihmë. Kompania e pestë ka arritur me vonesë te porta e vogël në kështjellë, duke iu mundësuar kështu disa nga banorëve që të largohen. Për kompaninë e dytë dhe të tretë nuk ka më tej shpjegime se me çfarë janë përballur.

Ndërkohë që zhvilloheshin këto veprime ushtarake, banorët e prapatokës kishin kuptuar se qyteti ishte nën sulm dhe kanë bërë përpjekje për të ardhur në ndihmë. Përmenden deri në dyqind kalorës si dhe këmbësorë. Nëse do të marrim të mirëqenë përshkrimin se janë tërhequr nën fërshëllimën e plumbave të mushketave spanjolle, duhet menduar se nuk ishin ushtarë por civilë. Pika më e afërt ku ata arritën shkruhej se ishte pothuaj 20 hapa larg Portës së Madhe (afërsisht 6 m), por ura e thyer që kalonte mbi hendek ishte bërë pengesë për hyrjen e tyre brenda mureve.

Me këto aktivitete ushtarake praktikisht qyteti ishte pushtuar dhe ushtarët spanjollë ishin tashmë zotër të Durrësit. Pas pushtimit të kështjellës mbi kodër markezi ka dhënë urdhër të fillonte plaçkitja. Kontrolli i plotë spanjoll kishte bërë që drejtuesit e flotës të darkonin në bregdet, ndërsa anijet ishin vendosur në pozicion mbrojtës. Katër galera ishin ankoruar në krahun lindor, për të goditur përforcimet osmane që synonin të afroreshin duke kaluar nëpër kanalin që lidhte kënetën me detin. Katër galera në krahun perëndimor dhe gjashtë të tjera kishin hedhur ankorë përballë mureve. Kështu kemi edhe numrin total të anijeve që kanë marrë pjesë në sulm, 14 të tilla.

Tërheqja e ushtarëve spanjollë ka filluar para perëndimit të diellit nëpërmjet Portës së Detit. Në fund ndiqte praparoja (kompania e dytë dhe e pestë), që ruanin tërheqjen nga ndonjë sulm i papritur.

Spanjollët kishin vendosur të shpërthenin kështjellën për ta shkatërruar. Për këtë arsye ishin vendosur fitila zjarri ndër fuçitë e barutit. Nëse do të bazohemi te rrëfimi i Miguel de Castro-s, gjatësia e fitilave ishte lënë e tillë që t'iu mundësonte lundrimin anijeve për një milje e

gjysmë. Kur anijet spanjolle ishin 4 milje larg ka pasur një shpërthim shumë më të madh, aq sa ka zbardhëlluar natën. Duket se ka qenë shpërthimi i depos së barutit e cila gjendej në kështjellë, duke bërë që të fluturonin në largësi një sasi e madhe gurësh. Më pas, anijet spanjolle kanë vazhduar lundrimin të patrazuar dhe kanë arritur në Otranto.

### **Aspekte të zhvillimit të Durrësit**

Përshkrimet e dy dokumenteve japin mundësinë që të shihen edhe disa aspekte zhvillimore të Durrësit të vitit 1606. Por duke qenë se të dhënat e lidhura me këto aspekte janë të cunguara, lënë hapësira për hamendësime. Megjithatë, mendojmë se është me rëndësi që të trajtohen edhe ashtu siç janë, pasi do të krijonte mundësinë për diskutime dhe në të ardhmen të përmirësohen dhe të detajohen falë dokumenteve të reja.

#### *Madhësia e garnizonit osman*

Raporti i markezit ka renditur 400 kalorës dhe 600 këmbësorë osmanë të vrarë. Nuk mund të themi me siguri nëse te këmbësorët mund të përfshihen edhe meshkuj civilë apo jo. Të dhënat që përmendëm mbi madhësinë e garnizonit jepen pothuaj gjithmonë në rastet kur kishte ndërtime, ose përforcime të lidhura me rreziqe të pritshme. Përynjatim bën vetëm informacioni i vitit 1530. Për rrjedhojë, me rezerva, mund të themi se madhësia e garnizonit në periudha kohore kur nuk pritej ndonjë sulm duhet të ketë qenë si në vitin 1530, tek 255 veta. Ndërsa në periudha me pritshmëri sulmesh ky numër shkonte afërsisht në 700-800 veta. Për rrjedhojë, informacioni i markezit mund të interpretohet në dy forma: të gjithë të vrarët ishin ushtarë të garnizonit; 600 të vrarët këmbësorë duhej t'u përkisnin banorëve.

Në rastin e parë, nëse garnizoni natën e sulmit përbëhej prej 1 000 vetash, nënkupton të pasurit e informacioneve mbi sulme të mundshme. Në një rast të tillë nuk mund të mendojmë se të gjithë janë vrarë në luftime, ndërkohë që ka pasur vetëm dy të vrarë spanjollë. Në këtë rast, më së shumti, jam i prirur të shoh një masakrim të tyre.

Arsyet që mbështesin mendimin e dytë lidhen me disa elemente:

- Shifra prej 1 000 ushtarësh do të nënkuptonte një situatë alarmante, por gjendja e përgjumur e mbrojtjes bie tërësisht në kundërshtim me një gjë të tillë.

- Vetë markezi numëron 200 kuaj të vrarë, ndërkohë që kalorësit e vrarë shënohen 400 të tillë. Markezi dhe ushtari Miguel nuk përmendin në asnjë rast marrjen e 200 kuajve të tjerë në anijet spanjolle. Si mund të ishin 400 kalorës osmanë me 200 kuaj?

- Ushtari Miguel tregon qartazi vrasjet e bëra ndaj civilëve në qytet, ndërkohë që markezi nuk përmend kurrkund një gjë të tillë, por vetëm se ka dhënë urdhër për plaçkitje.

Bazuar vetëm tek të dhënat spanjolle nuk mund të themi në formë të prerë nëse midis 1 000 të vrarëve ishin vetëm ushtarakë apo edhe civilë, por mundësia e dytë është më e madhe. Markezi në raportin e tij ndoshta (dhe natyrshëm), duhet të ketë fshehur vrasjet e civilëve.

### *Numri i banorëve*

Përlllogaritja e humbjeve njerëzore ndër popullatën civile paraqitet e vështirë. Vlerësimin e përafërt të banorëve të Durrësit më 5 gusht 1606 do ta bëjmë të ndarë në dy forma: *së pari*, duke përlllogaritur sasinë prej 1 000 të vrarësh si ushtarakë, dhe *së dyti*, duke përlllogaritur 600 këmbësorët si civilë.

Humbjet njerëzore paraqiten të konsiderueshme për një vendbanim të përmasave të Durrësit në vitin 1606. Flitet qartësisht për popullsi të masakruar e pjesërisht të skllavëruar. Një pjesë e vogël e banorëve ka arritur të arratiset nëpër portën e vogël të kështjellës. Por ajo gjendet lart në kodër, që do të thotë se vetëm disa nga banorët e ekstremit perëndimor të kalasë kanë pasur mundësi dhe kohë që të largohen. Përshkrimet e ushtarit Miguel de Castro janë një tregues i qartë i mizorive të kryera. Një informacion me interes është se shumica e popullsisë ishin femra, pasi meshkujt me sa duket gjendeshin nëpër ara, ku punonin tokat. Banorët që kanë shpëtuar të gjallë nga sulmi, 155 veta, janë skllavëruar dhe marrë në anije.

Mund të hamendësojmë se të vrarët bashkë me të larguarit nga porta e vogël e kështjellës nuk mund të jenë më shumë sesa skllëvërit, duke pasur kështu një shifër prej gati 300 civilë. Kjo shifër ngjason me numrin e forcave të parregullta që ndihmonin garnizonin për mbrojtje në vitin 1570. Edhe nëse do të ishim të saktë në këtë përlllogaritje të numrit të banorëve, nuk duhet të harrojmë se na mungon numri i atyre që ishin larguar për të punuar arat (nëse informacioni përkatës është i vërtetë). Sidoqoftë, deri në zbulimin e dokumenteve osmane me numrin e

banorëve, duke ndarë të vrarët ushtarë nga ata civilë, mund të arrijmë në një popullsi civile diku tek 300 veta, por jo më shumë se 500 veta. Një pjesë e tyre, siç tregohet nga Miguel de Castro, por edhe nga relacioni i vitit 1570, ishin familjarë të ushtarakëve të garnizonit osman.

Në rastin e dytë, nëse do të interpretonim 600 të vrarët e quajtur “këmbësorë” si pjesë të popullatës civile, modeli përlllogaritës do të ndryshonte rrënjësisht. Këtij numri duke i shtuar edhe 155 veta të kapur skllëvër, do të kishim 755 veta. Duhet të përfshijmë edhe numrin e të arratisurve nga porta e vogël në kështjellë, si dhe ata që gjendeshin jashtë mureve. Në total do të kishim një popullsi civile më pak se 1 000 banorë.

Vetëm 4 vite më pas, më 1610, Durrësi konsiderohej më pak i banuar dhe arsyeja lidhej me plaçkitjen spanjolle.<sup>22</sup> Në vitin 1640 përmenden vetëm 300 shtëpi, por nuk qartësohet nëse ndodheshin brenda kalasë apo edhe jashtë saj. Bashkë me rrethinat numëroheshin 2 000 vatra.<sup>23</sup> Nëse do të përlllogarisnim një numër mesatar banorësh për shtëpi nga 4 deri në 5 veta, do të kishim diku tek 1 200-1 500 banorë, por duke mos ditur nëse ato ishin brenda mureve apo edhe në rrethinën e afërt të tij. Sipas Evlia Çelebiut në Durrës kishte 150 banesa në kohën e vizitës së tij.<sup>24</sup> Në rastin konkret ai bën fjalë vetëm për territorin brenda kalasë, duke pasur kështu 600-750 banorë.

Këto të dhëna na paraqesin një mëdyshje në vlerësimin e numrit të banorëve. Pavarësisht se cili version është më afër së vërtetës, plaçkitja spanjolle jo vetëm ka zbrazur kalanë nga banorët, por ka bërë aq shumë dëme strukturore sa rikthimi i civilëve ka ndodhur shumë ngadalë.

<sup>22</sup> Franjo Racki (bot.), “*Izveštaj barskoga nadbiskupa Marina Bizzia o svojem putovanju god. 1610 po Arbanaskoj i Staroj Srbiji*”, në *Starine, na sviet izdaje Jugoslavenska Akademija Znanosti i Umjetnosti*, 20 (Zagreb: Knjizarnici Jug. Akademije, 1888), 70-106.

<sup>23</sup> Peter Bartl, *Albania sacra: geistliche Visitationsberichte aus Albanien, 2: Erzdiözese Durazzo* (Wiesbaden: Harrassowitz 2011), 105-114, “*Visitationsbericht Marco Scura, Bischof von Albano, vor 1640.*” M. Kiel në përmbledhjen për Durrësin në fjalorin islamik, këtë informacion e vendos në vitin 1610 si raport të ipeshkvit Mario Bizzi, dhe përlllogarit se numri i banorëve duhej të ishte 1 200-1 400 veta brenda në Durrës. Shih: Makiel Kiel, “*Draç*”, në *TDV İslam Ansiklopedisi*. 9 (İstanbul: Türkiye Diyanet Vakfı, 1994), 523.

<sup>24</sup> Robert Dankoff & Robert Elsie, *Evliya Çelebi. Seyahatnameh, Book of Travels*. Vol. II, *Evliya çelebi in Albania and adjacent regions (Kosovo, Montenegro, Ohrid)* (Leiden: Brill 2000), 127-153.

Më pak të dhëna rezultojnë mbi përkatësinë fetare të banorëve. Sipas fra Paolo Sarpi-t, në mes të banorëve të skllavëruar kishte 30 të krishterë, të cilët janë liruar në Pulja.<sup>25</sup> Disa nga detajet e informacionit të shënuar prej tij janë deri diku të ngjashme me ato të markezit (numri i skllëvërve dhe numri i topave). Prandaj jam i prirur të shoh më pranë së vërtetës edhe çështjen e të krishterëve. Për ekzistencën e një numri të paktë të krishterësh para vitit 1606 dëshmon edhe një relacion i shek. XVI.<sup>26</sup> Sasia e 30 të krishterëve mes 155 skllëvërve duhet parë si një element i rastësishëm. Për rrjedhojë, mund të hamendësojmë me një nivel deri diku të besueshëm se përqindja e tyre në mesin e banorëve të Durrësit në vitin 1606 luhatej në 19%.

Në vitin 1641, Mark Skura shkruante se nuk kishte asnjë të krishterë brenda mureve.<sup>27</sup> Në vitin 1662 përmenden vetëm dy familje ortodokse, që ishin tregtarë.<sup>28</sup> Po ashtu edhe në vitet 1668-69.<sup>29</sup> Në vitin 1670-71 përmenden vetëm katër katolikë dhe një prift ortodoks.<sup>30</sup> Këto pak të dhëna tregojnë se është dashur një periudhë e gjatë kohore që të kishte një rriardhje të të krishterëve në Durrës. Origjina e të krishterëve të vitit 1606 nuk është e qartë nëse lidhet me trashëgimtarët e të mbijetuarve të mundshëm pas vitit 1501, apo kishin ardhur pas këtij viti në Durrës. Arsyeja se përse nuk ka pasur më të krishterë për një kohë të gjatë pas vitit 1606 lidhet me dyshimin e osmanëve, se pushtimi erdhi si pasojë e bashkëpunëtorëve nga brenda qytetit. Si të tillë konsideroheshin prej tyre pikërisht të krishterët.

### *Baza ekonomike dhe zhvillimi i Durrësit*

Pas pushtimit të Durrësit në vitin 1501 perimetri i fortifikimeve u zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme. Duke ruajtur linjat juglindore, jugperëndimore dhe kështjellën në kodër, u ndërtua një linjë e re veriore.

<sup>25</sup> M. D. Busnelli, G. Gambarin (bot.), *Fra Paolo Sarpi...*, 99-100; I. Zamputi, *Dokumente të shekujve XVI-XVII ...*, dok. nr. 19 (63-64).

<sup>26</sup> S. Ljubic (bot.), *Starine na sviet izdaje...*, 201-202.

<sup>27</sup> P. Bartl, *Albania sacra...*, 115-128, "Visitationsbericht Marco Scura, Erzbischof von Durazzo, 1641."

<sup>28</sup> *Po aty*, 155-163, "Visitationsbericht Nicolo Carpeni, Erzbischof von Durazzo, 1662."

<sup>29</sup> *Po aty*, 164-166.

<sup>30</sup> *Po aty*, 181-194, "Visitationsbericht Gherardo Galata, Erzbischof von Durazzo, 1670/71."

Sipërfaqja që kufizonte ky perimetër ishte afërsisht 65 000 m<sup>2</sup> (6.5 ha). Duke hequr nga kjo shifër sipërfaqen e kështjellës mbi kodër që ishte territor ushtarak ku nuk lejoheshin banesa civile, sipërfaqja e banueshme përllogaritet në pothuaj 60 000 m<sup>2</sup> (6 ha).

Përqendrimi i banorëve brenda kësaj hapësire përsëri përllogaritet në bazë të dy hamendësimeve që kemi përmendur më lart. Për një popullsi 300-500 banorë do të kishim 1 banor për 120 deri 200 m<sup>2</sup> (0.012 deri 0.02 ha). Për një popullsi prej 1 000 banorësh do të kishim 1 banor për 60 m<sup>2</sup> (0.006 ha). Dallimi në mes këtyre të dhënave është shumë i theksuar, çka bëhet edhe më e qartë nëse përpiqemi të përllogarisim numrin e banesave të Durrësit. Banesat do të na rezultonin nga një minimum prej 60 deri në një maksimum prej 125 copë për një popullsi prej 300-500 banorësh. Ndërsa për një popullsi prej 1 000 banorësh do të rezultonin 200-250 të tilla.

Raporti i Santa Kruzit numëron 200 kuaj dhe 500 lopë të vrara. Ndërsa për 200 kuajt brenda mureve të kalasë do t'i shihnim si pjesë e garnizonit ushtarak, pra në shërbim të kalorësve, prania e lopëve na orienton drejt një tjetër elementi. Sasia prej 500 krerësh është e konsiderueshme për territorin e brendshëm të kalasë. Bazuar në këto shifra na rezulton se në Durrësin e vitit 1606 ka pasur një lopë për 120 m<sup>2</sup>, ose 83 copë për hektar. Në përllogaritjen përkundrejt numrit të popullsisë civile do të kishim 1.6 lopë për 1 banor (nëse qëndrojmë tek afërsisht 300 banorë), sasi e barabartë për një popullsi prej 500 banorësh, ose pothuaj 0.5 lopë për banorë në një popullsi prej më pak se 1 000 veta.

Përmendja e thasëve të shumtë me lesh që gjendeshin te Porta e Detit, të sistemuar për t'u ngarkuar në anije dhe të grabitura nga spanjollët, është një tjetër tregues ekonomik. Tashmë kemi të bëjmë me bagëti të imta, por nuk mund të thuhet nëse ato gjendeshin brenda mureve, apo thasët me lesh ishin sjellë nga prapatoka prej ndonjë tregtari vendës. Sasia e tyre e madhe, flet më shumë për sjelljen nga prapatoka me qëllim shitjeje. Pozicionimi në Portën e Detit, pranë skelës, duhet të nënkuptojë përgatitjen për t'u ngarkuar në njërën nga dy anijet që gjendeshin në ankorë pranë Durrësit.

Mungesa e një pjese të meshkujve brenda mureve është justifikuar nga ushtari Miguel me nevojën për punët e stinës në pronat bujqësore. Një përrshkrim i ngjashëm jepet edhe nga fra Paolo Sarpi.<sup>31</sup> Aspekti

<sup>31</sup> M. D. Busnelli, G. Gambarin (bot.), *Fra Paolo Sarpi ...*, 100.

bujqësor mund të lidhet ose me banorët që kishin prona tokësore në rrethina, ose me familjarët e ushtarëve. Sipas dokumenteve të cituara nga E. Caka, në shek. XVI një mënyrë e pagesës për ushtarët e garnizonit ishte dhënia e timareve.<sup>32</sup>

### *Armatimi dhe strukturat*

Pre e grabitjeve ranë edhe armatimet e kalasë. Si markezi Santa Kruz ashtu edhe Miguel de Castro përmendin sasinë e konsiderueshme të armëve të vogla të gjetura në depon e municioneve në kështjellë, që janë marrë nga spanjollët. Megjithëse prej të dyve cilësohen si armatime të vjetruara, asgjë nuk është lënë pas, por janë ngarkuar në anije.

Ndër kategoritë e armatimeve duket se më e pëlqyer ka qenë artileria. Sipas Miguel de Castro-s, në kështjellë numëroheshin 10 topa: shtatë mesatarë, dy *culebrinas*, një *canones de batir*. Në bastionin e poshtëm dhe te Porta e Detit përmenden 9 copë: tre kulebrina, dy *pedrero*, dy topa shkatërrues (*canones de batir*), dy topa të kalibrit mesatar. Përveç dy topave më të mëdhenj, numri i topave të marrë jepet prej tij 29 copë, konsideruar të një cilësie shumë të mirë.

Santa Kruz shkruante se u gjetën 18 topa bronzi në kështjellë, ndërsa në pjesën bregdetare të fortifikimeve, te Porta e Detit dhe strukturat pranë, ai shënon 22 topa të mëdhenj. Nga totali prej 40 topash u ngarkuan në anije 31. Nga topat e tjerë, që ishin shumë të mëdhenj, 4 u dëmtuan, ndërsa 5 u gozhduan. Në këtë rast të dhënat e markezit janë ato që duhen konsideruar të sakta.

Dëmet strukturore të shkaktuara në Durrës janë të lidhura me zjarrin që i është vënë qytetit fillimisht, e shpërthimi i fuçive të barutit më pas. Ushtari Miguel jep përshkrim bindës të dëmeve që pësoi kalaja nga zjarri. Këto shembje kanë krijuar vështirësi kalimi nëpër rrugica edhe për vetë ushtarët spanjollë. Ndërsa dëmet nga shpërthimet paraqiten edhe më të rënda. Nëse marrim për bazë përshkrimet duhet të mendojmë se dëmin më të madh e ka pasur kështjella mbi kodër. Niveli i shpërthimeve duhet të ketë qenë i tillë që praktikisht ka rrafshuar përgjithmonë strukturat brenda në kështjellë, me origjinë që nga ndërtimet anzhuine.

<sup>32</sup> E. Caka, “Tipologji të një qyteti kufitar...”, 74 dhe bibliografia e cituar.

## Çështje të paqarta

Një nga aspektet më pak të njohura lidhet me arsyet që çuan në një sukses kaq spektakolar të sulmit spanjoll. Si mund të shpjegohet fakti që nga i gjithë garnizoni osman vetëm katër veta përmenden të kenë dalë të armatosur? Si mund të kuptojmë vrasjen e të gjithë garnizonit osman, por vetëm dy të vdekur mes spanjollëve?

Sipas dokumenteve arkivore venedikasit ishin lajmëruar për hyrjen e flotës spanjolle në Adriatik, dhe me shumë mundësi ata kanë njoftuar edhe osmanët.<sup>33</sup> Për rrjedhojë, nuk ka mundësi që të mos kishte asnjë informacion mbi një aktivitet armiqësor të pritshëm në territoret e kontrolluara prej tyre.

Një tjetër informacion i dhënë disa vite pas sulmit e gjen arsyen e pushtimit të njerëzit që gjendeshin jashtë qytetit, pasi ishte sezoni i punëve bujqësore, por edhe i stinës kur ajri bëhej i rënduar.<sup>34</sup> Pak a shumë një gjë e tillë përmendet edhe nga ushtari Miguel de Castro. Por, sa i besueshëm është ky element? Një shpjegim i tillë na duket jo vetëm si shumë i thjeshtuar, por edhe i përsëritur ndër kronistët. Në periudhën postmesjetare një justifikim të tillë e hasim dy herë. Në rastin e parë është përmendur në lidhje me pushtimin osman të Durrësit, më 1501. Një kronikë shkruante se banorët gjendeshin jashtë qytetit, në tokat e tyre, pasi Durrësi ishte pushtuar nga ethet.<sup>35</sup> Pushtimi i vitit 1606 është rasti tjetër ku hasim një justifikim të ngjashëm. Por, të mos harrojmë se meshkujt banorë të qytetit ishin njësi ndihmëse në mbrojtje, pasi nuk ishin ata përgjegjësit kryesorë për mbrojtjen. Edhe nëse do të kishin dalë jashtë mureve vetë ushtarët osmanë të garnizonit për arsye të njëjtë, përsëri nuk mund të japim një shpjegim për një rezistencë kaq të dobët në mbrojtje. Logjika ushtarake kurrsesi nuk do të lejonte daljen e të gjithë ushtarëve jashtë mureve. Një numër minimal i ngarkuar me ruajtjen duhej të gjendej detyrimisht brenda kalasë.

<sup>33</sup> A. Muhaj, *Nga Ballkani në Mesdhe...*, 103 dhe bibliografia e cituar prej tij.

<sup>34</sup> M. D. Busnelli, G. Gambarin (bot.), *Fra Paolo Sarpi...*, 99.

<sup>35</sup> Speratus Nodilo, *Annales Ragusini Anonymi item Nicolai de Ragnina. volumen decimum quartum. Monumenta spectantia Historiam Slavorum Meridionalium* (Zagabria: Ex Officina Societatis Typographicae, 1883), 84; Përkthyer nga I. Zamputi, *Dokumente të shekujve XVI-XVII ...*, dok. nr. 230 (298-299).

Nëse befasia e sulmit spanjoll ishte aq e madhe, sado të mundoheshin për t'u afruar pa asnjë zhurmë te dera e jashtme e Portës së Detit dhe ta shpërthenin pa u vënë re, vazhdimi më tej i sulmit e kishte humbur befasinë. Veprimet e nevojshme për të shpërthyer derën e dytë kanë kërkuar kohë jo të paktë. Edhe nëse njësitë e garnizonit, që ishin vendosur te linja e mureve përballë bregdetit, nuk do të kishin mundësi të bënin ndonjë lloj rezistence efektive, njësitë në kështjellë kishin kohë të mjaftueshme. Në qoftë se do të hamendësojmë minutat e kaluara nga një operacion tek tjetri, mendojmë se ka kaluar më së paku 10 minuta nga përfundimi i shpërthimit të derës së parë deri në finalizimin e shpërthimit të derës së dytë të kompleksit të Portës së Detit. Nga hyrja në qytet deri në ngjitjen te porta e kështjellës në kodër, sado që të ketë shpejtuar kolona e parë spanjolle, nuk do të mund ta bënte këtë rrugë në më pak se 15 minuta. Largësia në vijë ajrore nga Porta e Detit te porta e kështjellës është 440 m, ndërsa rrugicat me kthesa dhe relievi në ngjitje. Kjo përlllogaritje na tregon se njësitë ushtarake osmane të vendosura në kështjellë duhej të kishin të paktën 25 minuta kohë nga shpërthimi i derës së parë te Porta e Detit deri në përballjen me ushtarët spanjollë brenda në kështjellë. Si ka mundësi që një kohë e tillë nuk ka mjaftuar për të kështjellë dhe për të filluar mbrojtjen efektive? Në këtë rast mbetet e paqartë dhe problematike për t'u kuptuar mospërputhja e rrëfimeve mes ushtarit Miguel dhe markezit, ku i pari nuk përmend asnjë betejë në kështjellë, ndryshe nga i dyti.

Një tjetër element që e bën edhe më të mjegullt situatën lidhet me një sërë dokumentesh arkivore lindore dhe perëndimore, të cilat flasin mbi masat e herëpashershme të ndërmarra nga osmanët për të mbrojtur qytetin, bazuar tek informacionet që kishin. Në vitin 1604, një letër e parisë dhe e esnafëve të Elbasanit tregon se ata ishin ngarkuar të shkonin në ndihmë të mbrojtësve të kalasë së Durrësit në rast të ndonjë sulmi të mundshëm «*të flotës së kaurrve*».<sup>36</sup> Ky informacion mund të ishte sa një formë angazhimi mbrojtjeje në raste nevojë, aq edhe një e dhënë se pritej një sulm i afërt në kohë. Në rastin e vitit 1606, venedikasit kishin të dhëna për një aksion të shpejtë spanjoll në Shqipëri. Angazhim ky që

<sup>36</sup> *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë, Shqipëria nën sundimin feudal-ushtarak otoman (1506-1839)*, vëll. III, përgatitur nga Aleks Buda, Injac Zamputi, Stavri Naçi, Zija Shkodra (Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës, 1962), dok. nr. 99 (149).

kishte kohë që shfaqej me aksione të ndryshme ushtarake<sup>37</sup> dhe ka vazhduar për një periudhë të gjatë kohore.<sup>38</sup> Për rrjedhojë, nuk do të ishte e çuditshme që osmanët të kishin informacione të dërguara nga venedikasit, të cilët e konsideronin Adriatikun si një hapësirë, dominimi i së cilës i takonte vetëm atyre që nga kohët hershme.<sup>39</sup> Sipas të dhënave të botuara nga A. Muhaj, osmanët ishin njoftuar nga ana e venedikasve mbi një sulm spanjoll në brigjet shqiptare vetëm pak kohë para plaçkitjes.<sup>40</sup>

Këto detaje dëshmojnë se ka ende elemente të panjohura, që mund të shpjegojnë suksesin spanjoll. Dyshimi osman se të krishterët e Durrësit kanë bashkëpunuar me sulmuesit mund të jetë edhe një shpjegim. Vetë markezi shkruante se ka pasur informacione mbi Durrësin nga disa persona, të cilët i kanë siguruar se mund të pushtohet pa rreziqe. Përkundrejt këtij informacioni, vetë fakti që, si Miguel de Castro ashtu edhe markezi Santa Kruz tregojnë se nuk e prisnin një derë të dytë brenda kompleksit të Portës së Detit, hedh dyshime të forta mbi ndihmën nga brenda mureve. Për momentin nuk mund të thuhet me siguri nëse ka pasur një ndihmesë të tillë nga brenda Durrësit, apo të dhënat që janë marrë ishin nga tregtarë të rastit.

Mungesa e vigjilencës nga mbrojtësit mbetet sigurisht arsyeja kryesore për situatën e krijuar. Nga ana venedikase vlerësohej se pushtimi ishte rrjedhojë e neglizhencës.<sup>41</sup> Kjo mungesë vigjilence do të çonte patjetër në pushtim, por nuk mund të shpjegojë dallimin e madh mes të vvarëve. Forca mbrojtëse ishte më se e mjaftueshme për t'u bërë ballë spanjollëve, nëse mbështetemi te përllogaritja standarde se për të korrur sukses në sulm duhen 3 sulmues për 1 mbrojtës.<sup>42</sup> Për rrjedhojë, duhet të ketë pasur ndonjë tjetër arsye që ka luajtur një rol vendimtar në suksesin spanjoll. Një nga arsyet mund të lidhet me leximin e shifrave të

<sup>37</sup> P. Xhufi, *Árbërit e Jonit...*, 697-700.

<sup>38</sup> Për një prezantim të detajuar të aktivitetit spanjoll shih vëllimin e Peter Bartl, *Wer Westbalkan zwischen spanischer Monarchie und osmanischem Reich: Zur Türkenkriegsproblematik an der Wende vom 16. zum 17. Jahrhundert* (Wiesbaden: Harrassowitz in Komm., 1974).

<sup>39</sup> P. Xhufi, *Árbërit e Jonit...*, 798 dhe bibliografia e cituar prej tij.

<sup>40</sup> A. Muhaj, *Nga Ballkani në Mesdhe...*, 103 dhe bibliografia e cituar prej tij.

<sup>41</sup> Maria Pia Pedani, *Ottaviano Bon (1609), Relazioni di ambasciatori veneti al Senato* (Archivio di Stato di Venezia, Collegio, Relazione b.5), 477-523. [botim online], 516-517.

<sup>42</sup> John J. Mearsheimer, "Assessing the Conventional Balance: The 3:1 Rule and its Critics", *International Security*, vol. 13, no. 4 (1989), 54-89.

paraqitura në raportin e markezit Santa Kruz. Numri i të vrarëve të identifikuar si këmbësorë duhet të shihet si banorë civilë, dhe garnizoni të kishte në të vërtetë 400 ushtarakë. Në këtë formë, fuqia sulmuese spanjolle përkundrejt garnizonit (në raportin 8 me 1) do të mposhtte mbrojtjen edhe sikur të mos ishte e përgjumur.

### **Gjurmët që la pas**

Pushtimi i vitit 1606, megjithëse i përkohshëm, ka lënë gjurmë në kujtesën popullore të shqiptarëve, të cilët mendonin se bëhej fjalë për një fushatë të mbretërive perëndimore kundër osmanëve dhe shprehnin gatishmërinë për t'u hedhur në kryengritje. Kjo ndjenjë shprehet jo vetëm në vitet që pasuan pushtimin, por edhe disa dekada më vonë. Në vitet e para pas ngjarjes ka qenë Nikollë Mekajshi, i cili përpiquej të siguronte mbështetjen e Papatit për një kryengritje antiosmane. Në një letër të vitit 1608, ai paraqet një plan kryengritjeje që do të kishte sukses dhe kujton pushtimin e Durrësit nga spanjollët si model.<sup>43</sup> Duke qenë se një organizim i tillë nuk ndodhi, Mekajshi vazhdonte të insistonte. Më 15 korrik 1610, ai ka shkruar një tjetër plan të detajuar dhe përsëri jep si shembull sulmin spanjoll mbi Durrësin.<sup>44</sup>

Ndërkohë që shqiptarët kërkonin mbështetje nga Papati për një kryengritje antiosmane, aktiviteti spanjoll në brigjet shqiptare vazhdoi për disa vite. Gatishmëria shqiptare për t'u hedhur kundër osmanëve në bashkëpunim me spanjollët shprehet në një sërë dokumentesh, por nuk u arrit asnjëherë krijimi i një fushate të gjerë.<sup>45</sup> Kujtimi i këtij pushtimi të shkurtër vazhdonte të ishte i gjallë për vite me radhë, siç kuptohet qartë në një letër të Pjetër Budit, të 15 shtatorit 1621, ku tregohet për perceptimin shqiptar se në vitin 1606 ishin në prag të një fushate perëndimore antiosmane. “Nëse një princ perëndimor do të vinte në

<sup>43</sup> I. Zamputi, *Dokumente të shekujve XVI-XVII ...*, dok. nr. 9 (43-49).

<sup>44</sup> Augustino Theiner, *Vetera Monumenta Slavorum Meridionalium*, vol. II (1524-1800) (Zagabriae: Ex officina Societatis Typographicae, 1875), dok. nr. 134 (111-112); I. Zamputi, *Dokumente të shekujve XVI-XVII...*, dok. nr. 165 (247-255).

<sup>45</sup> P. Xhufi, *Árbërit e Jonit...*, 441-786, paraqet në formë të qartë të gjitha përpjekjet nga ana e shqiptarëve dhe përfaqësuesve të tyre për të gjetur përkrahje e ndihmë ushtarake mes fuqive europiane.

Shqipëri, - vazhdonte Budi, - deri në 30 000 shqiptarë do të ngriheshin në luftë”.<sup>46</sup>

Një shans i tillë për të filluar një kryengritje masive u tret dhe nuk u rikthye më kurrë. Ato kanë mbetur vetëm në kuadrin e përpjekjeve të veçuara, dhe jo si pjesë e një programi të mirëmenduar dhe gjithëpërfshirës, si në rastin e vitit 1690 nga flota e venedikasve,<sup>47</sup> ku një stuhi detare nuk lejoi zbakimin, ndërkohë që trupat e shumta osmane ishin vendosur në bregdet dhe ndiqnin situatën.<sup>48</sup> Nuk kanë qenë të pakta rastet kur klerikët katolikë të emëruar si ipeshkvij të Durrësit ishin në qendër të përpjekjeve për kryengritje antiosmane, në bashkëpunim me spanjollët, si p.sh. në vitet 1611, 1613, 1659, 1662. Për shumë arsye këto përpjekje dështuan dhe nuk u arrit në asnjë rast të ndërmerrej një kryengritje masive prospanjolle.<sup>49</sup>

### Në vend të përfundimeve

Me pushtimin e vitit 1501, Durrësi u bë përfundimisht pjesë e Perandorisë Osmane. Megjithëse u përfshi nga e ashtuquajtura *Pax Ottomana*, gjendja e qytetit u përmirësua me një ritëm shumë të ngadaltë. Shkëputja e lidhjeve ekonomiko-tregtare nga rrjeti detar, që kishte qenë gjithmonë arteria e jetës për Durrësin, e ktheu atë thjesht në një kala periferike, e banuar nga garnizoni që e mbronte. Banorët civilë që kanë filluar ta banojnë të parët, duhet të kenë qenë familjet e ushtarakëve. Ky proces zhvillimor ka zgjatur jo pak. Nga momenti i pushtimit të vitit 1501 deri në vitin 1606 kishte kaluar pak më shumë se një shekull. Mëdyshja në sasinë e numrit të banorëve (300-500 apo 1 000 veta) është një mangësi që ka nevojë të sqarohet, pasi në rastin e parë (300-500 banorë) do të kishim një nivel zhvillimi të barabartë me një fshat të madh. Raporti i përafërt i civilëve përkundrejt ushtarakëve do të ishte nga

<sup>46</sup> I. Zamputi, *Dokumente të shekujve XVI-XVII ...*, dok. nr. 211 (376-389). Një përkthim anglisht jepet nga Robert Elsie, *Early Albania, a Reader of Historical Texts, 11th - 17th Centuries* (Wiesbaden: Harrassowitz, 2003), 170-177.

<sup>47</sup> Pietro Garzoni, *Istoria della Repubblica di Venezia in tempo dela Sacra Lega contro Maometto IV., e tre suoi Successori, Gran Sultani de Turchi* (Venezia: 1720), 370; P. Xhufi, *Árbërit e Jonit...*, 902.

<sup>48</sup> Camillo Contarini, *Istoria della Guerra di Leopoldo Primo Imperadore e de' Principi Collegati Control il Turco, dall'anno 1683 fino alla pace*, Parte Seconda (Venezia: Apresso Michele Herz 2 Antonio Bortoli, 1710), 259.

<sup>49</sup> P. Xhufi, *Árbërit e Jonit...*, 682, 690, 1234, 1240.

1:3.3 deri në 1:2 (për 330 dhe 500 banorë përkatësisht). Në rastin e një sasive banorësh prej 1 000 vetash, jo vetëm që raporti përkundrejt numrit të ushtarëve do të përmbysesh tërësisht, por do të kishim tregues të një zhvillimi me ritme më të shpejta, sesa është menduar më herët.

Baza ekonomike, pavarësisht numrit të banorëve, ishte qartësisht e mbështetur te bujqësia. Numri i lartë i bagëtive të mbajtura brenda kalasë nënkupton oborre dhe haure rrotull shtëpive, tipar ky i një fshati. Lidhjet me detin duket se ishin të pakta. Me gjithë përmendjen e skelës dhe të raporteve tregtare, nuk ka të dhëna për nivele të konsiderueshme tregtie. Ndërsa banesat brenda kalasë përshkruhen të një cilësie shumë të dobët. Zjarret kanë arritur thjeshtësisht të shkatërrojnë edhe ndërtimet ku ishin përdorur gurë.

Këto përshkrime na shfaqin më së qarti pamjen që kishte Durrësi i vitit 1606: një garnizon kufitar, ku banorët civilë rezultojnë të jenë ose familjarë të ushtarakëve, ose bujq e blegtorë. Arsyeja e ekzistencës së Durrësit, duket se lidhej thjesht me faktin që gjendej në kufirin e Perandorisë. Si i tillë, ai duhej të ruhej nga një garnizon i përhershëm ushtarak, që të mos shërbente si urë zbarkimi për armiq të Perandorisë. Por edhe ky nivel zhvillimor ka pësuar një goditje të madhe nga plaçkitja spanjolle. Praktikisht është fshirë për së dyti gjithçka, nëse konsiderojmë pushtimin e vitit 1501 si shpartallimin e konceptit të një qyteti, dhe ka qenë e nevojshme të kalonin disa dhjetëvjeçarë që të rifillonte rimëkëmbja. Pikërisht këtu qëndron rëndësia e njohjes së saktë të nivelit të zhvillimit të Durrësit në vitin 1606. Ky moment përbën një element kyç për të kuptuar dhe për të shpjeguar evolucionin e tij përgjatë administrimit osman. Nëse popullsia do të ishte në nivelin e lartë të hamendësuar, plaçkitja spanjolle praktikisht ka ndërprerë ritmin normal të zhvillimit duke e kthyer 100 vite pas në kohë. Nëse do të kishim një popullsi në nivelin e poshtëm të hamendësuar, do të na rezultonte një ritëm zhvillimi 100-vjeçar minimal, ku plaçkitja spanjolle thjesht e ka shtyrë në kohë me disa dhjetëvjeçarë zgjerimin e vendbanimit.




Fig. 1




Fig. 2




Fig. 3

### EDUARD SHEHI

Institute of Archaeology / Academy of Albanological Studies, Tirana  
 eduardshehi@hotmail.com

### *S u m m a r y*

#### DETAILS ON THE ATTACK AND SACKING OF DURRËS IN 1606 ACCORDING TO SPANISH SOURCES

The article deals with the occupation and sacking of Durrës on 05.08.1606, based on Spanish documents. The author describes the stages of the enterprise until their withdrawal, giving opinions on the location of the Spanish ships, the landing place, the route they followed to approach Durrës fortress and the military organization.

The data on the ottoman soldiers killed, 1000 of them, seems to indicate an abnormal situation. The garrison under normal peace conditions should have fluctuated around 255 people. Therefore, the amount noted by Marquis Santa Cruz is either indicative of a tense situation therefore the need for an increased garrison, or the killed civilians were also included in it. The author leans more towards the second explanation, thinking that the Marquis intended to cover up the killing of civilians.

According to the available data and the interpretation of the killed, the population can be calculated in two versions: 300-500 people, or approximately 1000. About 19% of this population must have been Christians. After the murders and enslavement Durrës has suffered a complete emptying. It would take several decades to reach the same stage of development.

The economic basis of the population was agriculture and farming. Considering the descriptions and other documentary data, it turns out that Durrës in 1606 resembles a fortified village.

The simplicity with which Durrës was conquered and the number of Ottoman killed compared to the Spanish ones is strange to explain. In addition to the sleepiness of the defensive garrison, and the superior force of the Spaniards, a partial explanation can be related to the collaboration of the attackers with individuals within the walls.

The Albanians thought, and hoped, that such an attack was a prelude to a larger anti-Ottoman action and expressed their readiness to rise to war. But such a thing did not happen, thus losing the last opportunity to liberate the territories of the western Balkans from the Ottoman rule.

